



Procesverbal 09/2020

I mbajtur me datën 27.09.2020 në mbledhjen e IX të rregullt të Komitetit për Komunitete, e udhëhequr nga z. Hajriz Haziri.

Mbledhja filloi në ora 11³⁰ h.

Kryesuesi Komitetit për Komuniteteve z. Hajriz Haziri – Përshëndeti të gjithë të pranishmit duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe e propozoi këto pika të rendit të ditës:

1. **Konfirmimi i pjesëmarrësve në mbledhjen e KK-ve;**
2. **Miratimi i rendit të ditës;**
3. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
4. **Edukimi.**
5. **Të ndryshme.**

Pika: 1

Kryesuesi Komitetit për Komuniteteve z. Hajriz Haziri - Fillimisht e konfirmoi pjesëmarrjen e anëtarëve të KK-ve. Prezent ishin gjashtë anëtarë të Komitetit për Komunitete.

Pika: 2

Miratimi i rendit të ditës;

Miratohet rendi i ditës nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës.

Pika: 3

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

Pika: 4

Edukimi:

Kryesuesi Komitetit për Komunitete z. Hajriz Haziri - Në fshatin Zaskok në klasën e parë janë gjithsej 43 nxënës të komuniteteve, në shkollën “Ahmet Hoxha” janë gjithsej 16 nxënës dhe në shkollën fillore “Tefik Çanga” 14 nxënës të gjithë të klasës së parë. Falënderojmë Nënkryetarin e komuniteteve dhe DKA-në për ndihmën e dhënë në regjistrimin e nxënësve në shkollën e mesme të mjekësisë.

Nënkryetari i Komunës z.Florim Bajrami – MASHI na ka mundësuar përmes një marrëveshje që nxënësit e komuniteteve të pranohen në shkollë të mesme të lartë edhe me sukses të mirë jo vetëm të shkëlqyeshëm siç është kushti. UNMIK-u ka shpërndarë edhe tablet ku përmes DKA-së bëhet shpërndarja e tyre.


znj.Mimoza Pajaziti – Si është gjendja e nxënësve në fshatin Zaskok ku disa nga ta kanë braktisur shkollën, është mirë që në takimin e radhës të kemi informata rreth kësaj qështje pasi duhet të dimë se si do t'i kalojnë ata provimet për notim përfundimtar.

Pika: 5
Të ndryshme;


Kryesuesi Komitetit për Komuniteteve z. Hajriz Haziri - Pasi nuk ka diskutime të tjera e shpall të mbyllur mbledhjen e sotme.

Mbledhja përfundoi në 12⁰⁰h.

Procesmbajtja


Fitore Lipovica

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete


Hajriz Haziri

